



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.626/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “VALONI” me seli në Deçan me NUI 810132176, me përfaqësues sipas autorizimit Av.I.O. avokat nga Deçani, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit 188/21 të datës 02.02.2022, jashtë seancës me datë 28.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “VALONI” me seli në Deçan, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit 188/21 të datës 02.02.2022
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “VALONI” me seli në Deçan nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar I.O. avokat nga Deçani me datën 16.02.2022 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit 188/21 të datës 02.02.2022

Gjykata me datë 26.02.2024 paditësit “VALONI” seli në Deçan i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar paditësin që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’u paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia

është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 29.02.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

Ka.nr.626/22, datë 28.03.2024

Gjyqtarja
Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.